

LIGJ
Nr. 101/2018
PËR DISA SHTESA NË LIGJIN
NR. 93/2015, “PËR TURIZMIN”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, paragrafi numërohet me numrin 1 dhe pas tij shtohen pikat 2 e 3 me këtë përmbajtje:
“2. Përjashtohet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, çdo investitor/operator menaxhues, çdo person që është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i investitorit / operatorit menaxhues, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda tij, që është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
- b) korrupsion;
- c) mashtrim;
- ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;
- dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
- e) falsifikim;
- ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Për përfitimin e mbështetjes dhe të lehtësive të parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, subjektet e përcaktuara në pikën 2 duhet të paraqesin një vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekreten nr. 11005, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta